



Gjakovë, Djakovica - Gjakova
Kuvendi i Komunës - Gjakovë

01 Nr. _____ /2022

Datë: 28.07.2022

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit,12 dhe 40.2 shkronja i të Ligjit nr. 03/L040 për vetëqeverisje Lokale, dhe nenit 18.2 shkronja i të Statutit të Komunës së Gjakovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 28.07.2022, pas diskutimit lidhur me pikën e 14 të rendit të ditës: Formimi i Komisionit për emërtimin e rrugëve në Komunën e Gjakovës , e miratoi këtë:

V E N D I M

1. Formohet Komisioni për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave për Emërtimin e Rrugëve në territorin e Komunës së Gjakovës me këtë përbërje:

1. Znj. Arbëneshë Kuqi, Kryesues e Kuvendit .
2. Z. Him Zeqa , përfaqësues i Kuvendit
3. Znj. Ermira Mehmeti, Përfaqësuese e Kuvendit
4. Z. Ngadhujim Dana, Përfaqësues i Kuvendit
5. Z. Labehat Sadrija , Përfaqësues i Kuvendit
6. Z. Nexhdet Morina, përfaqësues i Kuvendit
7. Znj. Krenare Bushaj, përfaqësuese e Kuvendit
8. Znj. Eranda Kumnova , përfaqësuese e Ekzekutivit të komunës.
9. Z. Rozafat Hoxha , Përfaqësues i DUMM-së .

2. Ky Komision në bashkëpunim me Drejtoritë Komunale, duhet të veprojë në harmoni me dispozitat e Ligjit për Sistemin e Adresave, dhe të përgjigjen në ankesat dhe kërkesat e drejtuara për emërtimin e rrugëve në Komunën e Gjakovës .

4. Pas përfundimit të punës së këtij komisioni lista me emërtimet e propozuara të paraqiten në Kuvend për shqyrtim dhe miratim .

5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës .

6. Vendimi iu dërgohet:

- Kryetarit të Komunës së Gjakovës, z. Ardian Gjini
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
- Anëtarëve të Komisionit
- Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit .
- Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës
- Arkivit

